



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:276989
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05424700

Në ankesën e

AC-I-23-0196

Paditësi

D C, nga Prizreni.

Kundër

E paditura/Ankuesja

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2947 të datës 14 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2947 i datës 14 mars 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 08 nëntor 2013, paditësi e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ034-0781 të datës 21 tetor 2013, me të cilën ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensim e tri pagave të pa paguara në shumë prej 510,00 euro, me arsyetimin se paditësi në 6 muajt e fundit para datës së privatizimit të NSH "IFS Progres", në Prizren, 18 prill 2007, i njëjti nuk gjendet në listën e pagave dhe nuk figuron që është kryer ndonjë pagesë ndaj tij, si dhe nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së. Autoriteti i Likuidimit konstaton se kërkesa është parashkruar me datë 18 prill 2010, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi në ankesë i kundërshton pretendimet e Autoritetit të Likuidimit, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. Tutje paditësi pohon se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe gabimisht është zbatuar e drejta materiale. Paditësi me këtë ankesë ka dërguar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Librezës së punës, një kontratë pune të vitit 1996 dhe të vitit 1992 .

Me datë 22 gusht 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit ka vlerësuar saktë rrethanat faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat materiale. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa për paga është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësi nuk ka mund të provoj se këto paga i ka kërkuar më herët në gjykatë, por gjithashtu ai nuk ka ofruar prova se ka ofruar shërbime pune në NSH. Paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv në NSH, andaj nuk mund të pretendon paga për punën që nuk e ka kryer.

Me datë 03 shtator 2018, paditësi e pranoi mbrojtjen në ankesë të AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Me datë 11 tetor 2021, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshoi një Urdhër për paditësin, dhe kërkoi që ai të dërgon në gjykatë vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe prova shtesë në mbështetje të pretendimeve në ankesë.

Me datë 28 janar 2021, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Me këtë parashtresë ai ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, Letër konfirmimin e AKP-së lidhur me përvojën e punës në NSH, kopjen e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 19 prill 2007, vendimin e pensionit bazë të datës 04.08.2016 dhe kopjen e Letërnjoftimit.

Me datë 14 mars 2023, shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-13-2947, ankesën e paditësit e aprovon si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe e obligon AKP-në që në emër të tri pagave të pa paguara ti paguaj paditësit shumën prej 510, sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se NSH-ja është privatizuar me datë 18 prill 2007. Paditësi ka sjellë Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopjen e Librezës së punës, në bazë të cilave dëshmi shihet se ai ka punuar në NSH deri me 18 prill 2007, kur është privatizuar NSH-ja. Tutje shkalla e I-rë konstaton se këto prova vërtetojnë faktin se paditësi ka punuar në NSH dhe ka ofruar shërbime pune deri në ditën e privatizimit. Andaj paditësit i është njohur e drejta në pagesën e tri pagave të pa paguara në shumë prej 510.00 euro, duke u bazuar në faktin se AKP-ja me mbrojtjen në ankesë fare nuk e ka kontestuar lartësinë e shumës së kërkuar. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se nuk është i bazuar pretendimi i të paditurës se kërkesa është parashkruar, kjo për faktin se paditësi e kishte pranuar njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 19 prill 2007 i cili dokument e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit. Shkalla e I-rë i referohet edhe disa rasteve tjera nga jurisipodencia e Kolegjit të Apelit.

Me datë 31 mars 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-2947 të datës 14 mars 2023, për shkak të gjitha bazave ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e

likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja pretendon se kërkesa për pagesën e tri pagave është parashkruar në bazë nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, duke qenë se paditësi nuk ka ndërmarr veprime për ta ndërprerë rrjedhën e parashkrimit në afatin e 3 viteve nga koha kur pretendohet se ka lindur obligimi i NSH-së për pagesën e pagave.

Me datë 07 qershor 2023, paditësi e ka pranuar ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat, dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 07 gusht 2013, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për pagesën e 3 pagave të pa paguara në shumë prej 510.00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si e pa vlefshme nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se NSH "IFS Progres" është privatizuar me datë 18 prill 2007, dhe kjo është vërtetuar edhe me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe Librezën e punës të cilat paditësi si prova i ka sjellë në Shkallën e I-rë në mbështetje të ankesës së tij.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, Letër konfirmimin e AKP-së lidhur me përvojën e punës në NSH, kopjen e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 19 prill 2007, vendimin e pensionit bazë të datës 04.08.2016 dhe kopjen e Letërnjoftimit dhe kopjen e Librezës së punës.

Duke u bazuar në këto prova që u cekën më lartë, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e ka aprovuar ankesën e paditësit, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe paditësit me të drejtë ia ka njohur të drejtën në tri paga të fundit të pa paguara në shumë prej 510.00 euro, për faktin se ai kishte ofruar shërbime punë në NSH deri në ditën e privatizimit të saj.

Është i saktë konstatimi i Shkallës së I-rë se paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e shumës së kërkuar në emër të tri pagave të pa paguara, andaj duke u bazuar në këtë fakt paditësit i është njohur shume e kërkuar prej 510.00 euro, e cila duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga këto arsye, është refuzuar ankesa e të paditurës si e pa bazuar dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 01 qershor 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 07 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
